REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:276318

Datë: 31.10.2022

Numri i dokumentit: 03587244

**P.nr.1354/2021**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,** Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nacis Sarani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit R.Xh.,, nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 197 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.2400-15/2021 të datës 08.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Beqë Shala, të akuzuarit, më date 24.10.2022 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 31.10.2022 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**R.XH.,,** nga i ati **.....** dhe nëna **.....**e lindur **.....**, i lindur më datë **.....**në Prizren, tani jeton në fshatin **.....**, Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Nga data e pa vërtetuar gjerë më datë 18.10.2020, në fshatin Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, në mënyrë të kundërligjshme hynë në shtëpinë e mbyllur të të dëmtuarit – babait të tij M.Xh., në atë mënyrë që pasi i pandehuri pretendon se shtëpia në fjalë është lënë trashëgimi nga gjyshi i tij dhe i njëjti ka pjesë në këtë shtëpi edhe përkundër faktit se ekziston Aktgjykimi C.nr.889/16, i datës 19.07.2017, i Gjykatës Themelore në Prizren, përmes të cilit është urdhëruar i pandehuri që së bashku me familjen e tij të largohen nga shtëpia e të dëmtuarit, ashtu që i pandehuri duke e shfrytëzuar kohën kur i dëmtuari ka qenë jashtë shtetit, vendoset me familje në këtë shtëpi dhe atë derisa i dëmtuari kthehet në Kosovë dhe kupton për këtë fakt, me ç'rast menjëherë e njofton policinë.

Kësodore ka kryer veprën penale cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 197 par.1 të KPRK-ës.



2021:276319

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 4 par.1 nënpar. 1.4, 7, 17, 69, 70, 81, 82 par.1, par.3 dhe par.5, dhe nenit 197 par.1 të KP-ës, te akuzuarit i shqipton:

**VËREJTJE GJYQËSORE**

Duke i bërë me dije të akuzuarit se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryer prapë vepër të tillë gjykata do t'i shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

I dëmtuari: M.Xh., nga fshati **.....**, Komuna Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari qe t'i paguaj shpenzimet e procedurës, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20,00 Euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave shumën prej 30,00 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.2400-15/2021 të datës 08.12.2021, kundër të akuzuarit R.Xh.,, nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 197 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Beqë Shala, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzë PP/II.nr.2400-15/2021 të datës 08.12.2021, kundër të akuzuarit R.Xh.,, nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 197 par.1 të KPRK-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethana cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

I akuzuari R.Xh.,, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, pasi që të gjitha të cekurat në aktakuzë sa i përket kohës dhe vendit si dhe mënyrës janë të vërteta, por i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh se unë me të dëmtuarin jam në raporte familjare, të njëjtin e kam baba, i njëjti përkohësisht jeton, punon dhe vepron në botën e jashtme, respektivisht në Gjermani, dhe pas paraqitjes të rastit, unë këtë pronë e kam liruar.

Pos të cekurave më lart, i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, të ketë parasysh edhe faktin e rrethanave lehtësuese dhe ato sa i përket rrethanave të mija personale, se kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, e po ashtu të ketë parasysh edhe rrethanat e mija familjare, që jam person familjar, baba i tre fëmijëve, dhe me punën time të kohë pas kohshme të punëtorit me vendosjen e gypave të ujit dhe ujësjellësit e siguroj ekzistencës e familjes time, andaj me këtë punë time të kohë pas kohshme i siguroj të ardhurat për ekzistencës e familjes sime si burim të vetëm të sigurimit të ekzistencës të familjes time.



2021:276319

Të gjitha këto rrethanat të cekura më lart i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Nga data e pa vërtetuar gjerë më datë 18.10.2020, në fshatin **.....**, Komuna e Prizrenit, i akuzuari në mënyrë të kundërligjshme hynë në shtëpinë e mbyllur të të dëmtuarit – babait të tij M.Xh., në atë mënyrë që pasi i pandehuri pretendon se shtëpia në fjalë është lënë trashëgimi nga gjyshi i tij dhe i njëjti ka pjesë në këtë shtëpi edhe përkundër faktit se ekziston Aktgjykimi C.nr.889/16, i datës 19.07.2017, i Gjykatës Themelore në Prizren, përmes të cilit është urdhëruar i pandehuri që së bashku me familjen e tij të largohen nga shtëpia e të dëmtuarit, ashtu që i pandehuri duke e shfrytëzuar kohën kur i dëmtuari ka qenë jashtë shtetit, vendoset me familje në këtë shtëpi dhe atë derisa i dëmtuari kthehet në Kosovë dhe kupton për këtë fakt, me ç'rast menjëherë e njofton policinë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 197 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KP-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 70 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, është person familjar, baba i tre fëmijëve, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, andaj gjykata pati parasysh faktin që të shqiptohet ky lloj i sanksionit si dhe peshën e veprës penale dhe llojin e saj, gjykata i shqiptoi vërejtje gjyqësore, duke i bërë me dije të akuzuarit se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryer prapë vepër të tillë gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK-së.



2021:276319

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450, 451 dhe 453 të KPP.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 par.3 pika 1 të ligjit me nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**
**P.nr.1354/2021 më datë 24.10.2022**

**Procesmbajtësja** **Gjyqtari**
**Nacis Sarani** **Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK**: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.



2021:276319